

---

**DEGA NE SHQIPERI E SHOQERISE  
ERNST & YOUNG  
EKSPERTE KONTABEL TE  
AUTORIZUAR SHKUP**

Raporti i Audituesit te Pavaruar dhe Pasqyrat  
Financiare per periudhen deri me 31 Dhjetor 2010

PERMBAJTJA:

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR	1
BILANCI KONTABEL	3
PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	4
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL	6
1. Informacion i pergjithshem	7
2. Bazat e pregatitjes se pasqyrave financiare	7
3. Politikat kontabel	10
4. Aktivet monetare	10
5. Aktive financiare afatshkurtra	11
6. Te tjera aktive financiare afatshkurtra	11
7. Tatim fitimi i parapaguar	11
8. Te ardhura te perlogaritura dhe shpenzimet e shtyra	12
9. Hua te dhena	12
10. Aktivet afatgjata	12
10. Aktivet afatgjata (vazhdim)	13
11. Furnitore dhe te tjera detyrime afatshkurtra	13
12. Kapitali aksioner	13
13. Te ardhurat	14
14. Kosto e punes	14
15. Shpenzime te tjera	15
16. Fitime / (humbje) nga kurset e kembimit	15
17. Shpenzimi i Tatimit mbi fitimin	16



## RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR

### Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare te Dega ne Shqiperi e Shoqerise Ernst & Young Ekspert Kontabel te Autorizuar Shkup (me poshte "Shoqeria") qe perfshijne pasqyren e gjendjes financiare me 31 Dhjetor 2010, pasqyren e te ardhurave permbledhese, pasqyren e flukseve te parave dhe pasqyren e ndryshimeve ne kapital per vitin e mbyllur ne kete date si dhe nje permbledhje te politikave kontabel kryesore dhe shenime te tjera shpjeguese.

#### *Pergjegjesia e Drejtimit per Pasqyrat Financiare*

Drejtimi i shoqerise eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te ketyre pasqyrave financiare ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit dhe me Ligjin Nr.9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te pasqyrave financiare pa gabime materiale, qofte nga mashtrime apo pasaktesira; perzgjedhjen dhe aplikimin e politikave te duhura kontabel dhe berjen e vleresimeve kontabel qe jane te pershtatshme per rrethanat.

#### *Pergjegjesia e Audituesit*

Pergjegjesia jone eshte te shprehim nje opinion mbi keto pasqyra financiare bazuar mbi auditimin tone. Ne kryem auditimin tone ne perputhje me Standartet Nderkombetare te Auditimit. Keto standarte kerkojne qe ne te respektojme kerkesat etike dhe te planifikojme dhe te kryejme auditimin me qellim qe te perftojme siguri te arsyeshme qe pasqyrat financiare nuk kane gabime materiale.

Auditimi perfshin procedura per te marre evidence auditimi per vlerat dhe paraqitjet ne pasqyrat financiare. Procedurat e perzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, perfshire dhe vleresimin e riskut te egzistences se gabimeve materiale ne pasqyrat financiare, qofshin rezultat i mashtrimeve apo pasaktesira. Ne berjen e ketyre vleresimeve, audituesi konsideron kontrollin e brendshem ne lidhje me pergatitjen dhe paraqitjen e drejte te pasqyrave financiare, por jo per qellimin e shprehjes se nje opinion mbi efektetiviteten e kontrollit te brendshem te entitetit. Nje auditim perfshin gjithashtu vleresimin per pershtatshmerine e parimeve kontabel te perdorura dhe arsyeshmerine e vleresimeve kryesore te bera nga drejtuesit, si dhe vleresimin e paraqitjes se pergjithshme te pasqyrave financiare.

Ne besojme se evidencat e auditimit qe kemi marre ofrojne baza te arsyeshme per dhenien e opinionit te auditimit.

*Opinion*

Sipas opinionit tone pasqyrat financiare paraqesin ne menyre te sinqerte ne te gjitha aspektet materiale gjendjen financiare te Deges ne Shqiperi te Shoqerise Ernst & Young Ekspert Kontabel te Autorizuar Shkup me 31 Dhjetor 2010, te rezultatit te saj financiar dhe te flukseve te saj te parave ne fund te vitit te mbyllur ne kete date ne perputhje me Standardet Kombetare te Kontabilitetit dhe me Ligjin Nr.9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

*Baker Tilly Albania Shpk.*

Baker Tilly Albania Shpk.

Tirane, me 03 Maj 2011



**BILANCI KONTABEL**  
me 31 Dhjetor 2010

	Shënime	Ne 31 Dhjetor	
		2010 LEK	2009 LEK
<b>AKTIVET</b>			
Aktive monetare	4	9.776.777	19.233.294
Aktive financiare afatshkurtra	5	15.974.563	12.037.397
Te tjera aktive afatshkurtra	6	1.541.479	2.197.833
Tatim fitimi i parapaguar	7	2.049.631	2.182.631
Te ardhura te perlogaritura dhe shpenzimet e shtyra	8	6.332.902	7.780.658
Hua e dhene	9	2.086.036	
<b>Totali aktiveve afatshkurtra</b>		<b>37.761.388</b>	<b>43.431.813</b>
Aktive afatgjata materiale		6.844.230	2.277.579
Aktive afatgjata jomateriale		254.620	268.819
<b>Totali aktiveve afatgjata</b>	10	<b>7.098.850</b>	<b>2.546.398</b>
<b>TOTALI AKTIVEVE</b>		<b>44.860.238</b>	<b>45.978.211</b>
<b>Detyrimet dhe Kapitali</b>			
Furnitore dhe te tjera detyrime afatshkurtra	11	24.009.695	26.248.448
<b>Totali i detyrimeve</b>		<b>24.009.695</b>	<b>26.248.448</b>
Rezerva ligjore		10.000	10.000
Rezerva te tjera		16.865.643	16.865.643
Fitime te pashperndara		2.854.120	11.415.278
Fitimi (humbja) e vitit financiar		1.120.780	(8.561.158)
<b>Totali i kapitalit</b>	12	<b>20.850.543</b>	<b>19.729.763</b>
<b>TOTALI DETYRIMEVE DHE KAPITALIT</b>		<b>44.860.238</b>	<b>45.978.211</b>

Bilanci kontabel duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 – 16 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare dhe shenimet shpjeguese nga faqja 3 deri 16 jane firmosur dhe aprovuar me 30 Mars 2011 nga:

Hartuesi

Olta Papadhopulli  
Financiere

Aprovuar

Photis Demetriou  
Administrator



*(Handwritten signature)*

PASQYRA E TE ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE  
per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2010

	Shënime	Per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor	
		2010 LEK	2009 LEK
<b>Te ardhurat</b>			
Te ardhurat nga shitja e sherbimeve		77.950.461	53.463.024
Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit		1.826.156	3.067.539
<b>Totali i te ardhurave nga shitja</b>		<b>79.776.617</b>	<b>56.530.563</b>
Te ardhura te perlllogaritura		5.493.947	7.585.549
<b>Totali i te ardhurave</b>	<b>13</b>	<b>85.270.564</b>	<b>64.116.112</b>
<b>Shpenzime operative</b>			
Kosto e punes	14	39.352.895	16.745.225
Amortizimet dhe zhvleresimet	10	1.076.321	633.184
Shpenzime te tjera	15	42.591.964	57.601.291
<b>Totali shpenzimeve</b>		<b>83.021.180</b>	<b>74.979.700</b>
<b>Fitimi / (humbja) nga veprimtarite kryesore</b>		<b>2.249.384</b>	<b>(10.863.588)</b>
Fitimet / (humbjet) nga kursi kembimit	16	(199.260)	2.302.430
<b>Fitimi / (humbja) para tatimit</b>		<b>2.050.124</b>	<b>(8.561.158)</b>
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	17	929.344	-
<b>Fitimi / (humbja) neto e vitit financiar</b>		<b>1.120.780</b>	<b>(8.561.158)</b>

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 – 16 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare

**PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE**  
per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2010

	Shënime	Per vitin e mbyllur ne 31 Dhjetor	
		2010 LEK	2009 LEK
<b>Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit</b>			
Fitimi (humbja) pas tatimit		1.120.780	(8.561.158)
Rregullime per:			
Amortizime dhe zhvleresime	10	1.076.321	633.184
Shpenzime per interesat		-	-
<b>Fitimi nga veprimtarite e shfrytezimit para rregullimeve ne kapitalin punues</b>		<b>2.197.101</b>	<b>(7.927.974)</b>
(Rritje) zvogëlim në tepricën e kërkesave të arkëtueshme dhe aktiveve te tjera		(1.833.056)	788,035
Rritje (zvogëlim) në tepricën e detyrimeve për t'u paguar nga aktiviteti dhe detyrimeve te tjera		(2.238.753)	21,190,930
<b>Fluksi monetar nga veprimtarite e shfrytezimit</b>		<b>(1.874.708)</b>	<b>14,050,991</b>
Interesi i paguar		-	-
Tatim mbi fitimin	17	133.000	(1.744.032)
<b>Fluksi neto monetar nga veprimtarite e shfrytezimit</b>		<b>(1.741.708)</b>	<b>12.306.929</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtaritë e investimit</b>			
Blerja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	10	(5.628.773)	(517.552)
Hua te dhena	9	(2.086.036)	-
<b>Fluksi neto monetar nga veprimtarite e investimit</b>		<b>(7.714.809)</b>	<b>(517.552)</b>
<b>Fluksi monetar nga veprimtarite e financimit</b>			
Disbursime nga huamarrje		-	-
Pagesa te huamarrjeve		-	-
<b>Fluksi neto monetar nga veprimtarite e financimit</b>		<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Rritja/(zvogëlimi) neto i mjeteve monetare</b>		<b>(9.456.517)</b>	<b>11.789.407</b>
Mjetet monetare në fillim të periudhës	4	19.233.294	7.443.887
<b>Mjetet monetare në fund të periudhës</b>	<b>4</b>	<b>9.776.777</b>	<b>19.233.294</b>

Pasqyra e flukseve monetare duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 – 16 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare

**PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL**  
per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2010

	Rezerva ligjore LEK	Rezerva te tjera LEK	Fitime te pashperndara LEK	Totali LEK
<b>Pozicioni ne 1 Janar 2009</b>	10.000	16.865.643	11.415.278	28.290.921
Transferimet e fitimeve te pashperndara	-	-	-	-
Fitimi / (humbja) e vitit	-	-	(8.561.158)	(8.561.158)
<b>Pozicioni ne 31 Dhjetor 2009</b>	<b>10.000</b>	<b>16.865.643</b>	<b>2.854.120</b>	<b>19.729.763</b>
<b>Pozicioni ne 1 Janar 2010</b>	10.000	16.865.643	2.854.120	19.729.763
Transferimet e fitimeve te pashperndara	-	-	-	-
Fitimi / (humbja) e vitit	-	-	1.120.780	1.120.780
<b>Pozicioni ne 31 Dhjetor 2010</b>	<b>10.000</b>	<b>16.865.643</b>	<b>3.974.900</b>	<b>20.850.543</b>

Pasqyra e ndryshimeve ne kapital duhet te lexohet se bashku me shenimet shpjeguese ne faqet 7 – 16 qe jane pjese perberese e pasqyrave financiare



## **1. INFORMACION I PERGJITHSHEM**

Shoqeria Ernst & Young Ekspert Kontabel Te Autorizuar Shkup, dega Shqiperi eshte shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar e krijuar me 12.01.2006 me numer regjistri tregtar 34715 e krijuar ne perputhje me Ligjin "Per Shoqerite Tregtare".

Aktiviteti kryesor i shoqerise eshte dhenia e sherbimeve te auditimit, konsulence per taksat dhe sherbime kontabiliteti.

Administratori i shoqerise eshte zoti Photis Demetriou. Me 31 Dhjetor 2010 shoqeria kishte 10 punonjes (31 Dhjetor 2009: 14 punonjes).

Qe prej 15 Tetorit 2010 selia qendrore e shoqerise eshte ne adresen "Rruga e Dibres, Godina Observator, Kati 7", Tirane. Selia e meparshme ishte Blvd Bajram Curri, ETC, Kati 9, Tinae. Ajo eshte regjistruar si person i tatueshem ne rrethin e Tiranës me numer identifikimi te personit te tatueshem K61911012I.

Pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2010 jane aprovuar nga administratori me 30 Mars 2011.

## **2. BAZAT E PREGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE**

### **a. Bazat e pregatitjes**

Pasqyrat financiare individuale jane pergatitur bazuar ne Standardet Kombetare te Kontabilitetit (SKK), te aplikueshme per pasqyrat financiare qe mbulojne periudhat duke filluar nga 1 janar 2009.

Te dhenat aktuale dhe krahasuese jane te shprehura ne Lek, e cila eshte dhe monedha funksionale e shoqerise.

Bazuar ne SKK 11 "Tatim Fitimi", paragrafi 4, Shoqeria ka zgjedhur te mos kontabilizojë tatimet e shtyra ne pasqyrat financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2010 (31 Dhjetor 2009)

### **b. Bazat e matjes**

Pasqyrat financiare jane pergatitur bazuar ne koston historike.

## 2. BAZAT E PËRGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

### c. Aktivët afatgjatë materiale dhe jomateriale

#### (i) Njohja dhe matja

Të gjitha aktivët afat-gjatë materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes si në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentet më të mëdhenj) të aktiveve afat-gjatë materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

#### (ii) Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjatë materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afat-gjatë materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

#### (iii) Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën lineare apo zbritëse të amortizimit, mbi jeten e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivët e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit. Toka nuk amortizohet.

Jetëgjatësia e vlerësuar për periudhën aktuale bazuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 3 datë 13 Prill 2003 si më poshtë:

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Përmirësim në qiramarrje	Lineare	Sipas kohëzgjatjes së qirasë
Makinë dhe pajisje	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Ndërtesa	Lineare	5%
Mobilje dhe orëndi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje zyresh dhe informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%
Mjete Transporti	Mbi vlerën kontabël neto	20%

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

Aktivët afatgjatë jomateriale njihen atëherë kur është e mundur që të përfitime ekonomike do të sigurohen në të ardhmen në lidhje me këto aktive dhe kostoja e tyre mund të matet në mënyrë të besueshme.

## 2. BAZAT E PERGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

### d. Llogarite e arketueshme dhe llogari te pagueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Veshirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### e. Paraja dhe ekuivalentet e parase

Paraja dhe ekuivalentet e parase përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat në Lek dhe në monedha të huaja. Për qëllimin e pasqyrës së flukseve monetare, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita pa afat ose me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

### f. Transaksione ne monedhe te huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare si dhe parapagimet në lidhje me AAM për t'u blerë në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave të bilancit në monedhë të huaj ishin si më poshtë (në Lek):

	<u>31 Dhjetor 2010</u>	<u>31 Dhjetor 2009</u>
1 EUR	138.77	137.96
1 USD	104.00	95.81

### g. Te ardhurat

Të ardhurat njihen në masën që është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike do të vijnë kompanisë dhe këto përfitime mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato kryhen. Të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përkasin.

## 2. BAZAT E PERGATITJES SE PASQYRAVE FINANCIARE (VAZHDIM)

### h. Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin është llogaritur në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi për tatimin mbi fitimin për periudhën e mbyllur më 31 dhjetor 2010. Tatimi mbi fitimin përfshin tërësisht tatimin mbi fitimin e llogaritur për periudhën kontabël. Tatimi aktual mbi fitimin llogaritet si 10% e fitimit të tatueshëm të përcaktuar në legjislacionin e kontabilitetit dhe legjislacionin tatimor në Shqipëri për vitin 2010 (2009: 10%)

### i. Biznesi ne vijimesi

Te dhenat e kontabilitetit jane mbajtur duke qene ne perputhje me parimet e pergjithshme te kontabilitetit, ne menyre te vecante me bazen e matjes me kosto historike, parimin e kontabilitetit rrjedhes, konceptin e kujdesit dhe me supozimin e biznesit ne vijimesi.

Pasqyrat financiare sipas legjislacionit janë përgatitur sipas parimit te vijimesise, i cili parashikon realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve gjatë ecurisë normale të biznesit.

## 3. POLITIKAT KONTABEL

Politikat kontabel jane organizuar bazuar ne ligjin per "Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

## 4. AKTIVET MONETARE

Aktivete monetare perbehen nga Paraja dhe ekuivalentet e parase dhe jane analizuar si me poshte:

	2010 LEK	2009 LEK
<b>Arka</b>	<b>923.272</b>	<b>217.500</b>
- ne Lek	176.827	92.833
- ne monedhe te huaj	746.445	124.667
<b>Llogari rrjedhese</b>	<b>8.853.505</b>	<b>19.015.794</b>
- ne Lek	217.620	515.418
- ne monedhe te huaj	8.635.885	18.500.376
	<u>9.776.777</u>	<u>19.233.294</u>

Dega ne Shqiperi e Shoqerise Ernst & Young EKA Shkup

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2010

**5. AKTIVE FINANCIARE AFATSHKURTRA**

Aktivitet financiare afatshkurtra perbehen nga klientet te cilet jane detajuar si me poshte:

	2010 LEK	2009 LEK
Kliente vendas	10.377.716	4.624.419
Kliente te huaj	344.150	3.362.196
Pale te lidhura	5.252.697	4.050.782
	<u>15.974.563</u>	<u>12.037.397</u>

**6. TE TJERA AKTIVE FINANCIARE AFATSHKURTRA**

Te tjera aktive financiare perbehen nga parapagimet per punonjesit, garanci te dhena te treteve dhe te tjera te drejta per tu arketuar.

	2010 LEK	2009 LEK
Parapagimet per punonjesit	1.080.610	1.501.214
Garanci dhene te treteve	446.130	637.944
Te tjera te drejta per tu arketuar	14.739	58.675
	<u>1.541.479</u>	<u>2.197.833</u>

**7. TATIM FITIMI I PARAPAGUAR**

	2010 LEK	2009 LEK
Tatim fitimi i parapaguar	2.049.631	2.182.631
	<u>2.049.631</u>	<u>2.182.631</u>

## Dega ne Shqiperi e Shoqerise Ernst & Young EKA Shkup

### Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2010

#### 8. TE ARDHURA TE PERLLOGARITURA DHE SHPENZIMET E SHTYRA

Te ardhurat e perllogaritura dhe shpenzimet e shtyra perfshijne:

	2010 LEK	2009 LEK
Te ardhura te perllogaritura	5.493.947	7.585.549
Shpenzime te periudhave te ardhshme	838.955	195.109
	<u>6.332.902</u>	<u>7.780.658</u>

Te ardhurat e perllogaritura kane te bejne me te ardhurat qe lidhen me pjesen e sherbimeve te kryera gjate 2010 por qe jane faturuar ne 2011 pas pranimit nga ana e klientit te kontrates se angazhimit.

#### 9. HUA TE DHENA

Huate e dhena perfshijne nje linje huaje te dhene per kompanine "Ernst & Young Albania Sh.P.K" me numer NIPT-i L01930009J, per qellim financimin e perkohshem te saj ne hapat e para te aktivitetit.

#### 10. AKTIVET AFATGJATA

Aktivete afatgjata jane analizuar si me poshte:

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2010	Mobilje dhe orendi LEK	Paisje zyre dhe informatike LEK	Programe LEK	Totali LEK
<b>Aktivete me kosto</b>				
Gjendja me 1 Janar 2010	1.094.699	2.993.352	338.671	4.426.722
Shtesat	4.306.844	1.282.886	39.042	5.628.772
Pakesimet	-	-	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2010	<u>5.401.543</u>	<u>4.276.238</u>	<u>377.713</u>	<u>10.055.494</u>
<b>Amortizimi</b>				
Gjendja me 1 Janar 2010	449.112	1.361.360	69.852	1.880.324
Shtesat	462.714	560.365	53.241	1.076.320
Pakesimet	-	-	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2010	<u>911.826</u>	<u>1.921.725</u>	<u>123.093</u>	<u>2.956.644</u>
Vlera e mbetur me 01 Janar 2010	645.587	1.631.992	268.819	2.546.398
Vlera e mbetur me 31 Dhjetor 2010	4.489.717	2.354.513	254.620	7.098.850

Dega ne Shqiperi e Shoqerise Ernst & Young EKA Shkup

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2010

10. AKTIVET AFATGJATA (VAZHDIM)

Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2009	Mobilje dhe orendi LEK	Paisje zyre dhe informatike LEK	Programe LEK	Totali LEK
<b>Aktivet me kosto</b>				
Gjendja me 1 Janar 2009	1.061.962	2.551.210	295.998	3.909.170
Shtesat	32.737	442.142	42.673	517.552
Pakesimet	-	-	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2009	<u>1.094.699</u>	<u>2.993.352</u>	<u>338.671</u>	<u>4.426.722</u>
<b>Zhvleresimi (Amortizimi)</b>				
Gjendja me 1 Janar 2009	293.851	931.570	21.719	1.247.140
Shtesat	155.261	429.790	48.133	633.184
Pakesimet	-	-	-	-
Gjendja me 31 Dhjetor 2009	<u>449.112</u>	<u>1.361.360</u>	<u>69.852</u>	<u>1.880.324</u>
Vlera e mbetur me 01 Janar 2009	768.111	1.619.640	274.279	2.662.030
Vlera e mbetur me 31 Dhjetor 2009	645.587	1.631.992	268.819	2.546.398

11. FURNITORE DHE TE TJERA DETYRIME AFATSHKURTRA

Te pagueshmet ndaj furnitoreve dhe te tjera detyrime afatshkurtra jane analizuar si me poshte.

	2010 LEK	2009 LEK
Furnitore vendas	4.343.993	1.796.436
Pale te lidhura	16.796.332	23.071.674
Detyrime ndaj personelit	1.011.018	62.838
Detyrime per sigurime shoqerore dhe shendetstore	237.121	273.991
Tatimi mbi te ardhurat personale	282.301	207.385
TVSH per tu paguar	959.979	711.551
Tatim ne burim	-	103.122
Te tjera detyrime	378.951	21.451
	<u>24.009.695</u>	<u>26.248.448</u>

12. KAPITALI AKSIONER

Ernst & Young EKA dega ne Shqiperi eshte dege e shoqerise Ernst & Young Eksperte Kontabel te Autorizuar Shkup shpk, dhe si e tille nuk ka kapital aksioner. Rezervat e tjera jane mbajtur sipas statutit dhe ligjit per shoqerite tregtare.

Dega ne Shqiperi e Shoqerise Ernst & Young EKA Shkup

Shenimet shpjeguese te pasqyrave financiare  
Per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2010

**13. TE ARDHURAT**

Te ardhurat jane analizuar si me poshte:

	2010 LEK	2009 LEK
Te ardhura nga shitja e sherbimeve	77.950.461	53.463.024
Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytezimit	1.826.156	3.067.539
Te ardhura nga shitja	<u>79.776.617</u>	<u>56.530.563</u>
Te ardhura te perllogaritura	5.493.947	7.585.549
Totali i te ardhurave	<u><u>85.270.564</u></u>	<u><u>64.116.112</u></u>

Te ardhurat nga shitja sipas kontabilitetit ndryshojne nga te ardhurat sipas deklarimeve per TVSH-n (FDP) per pjesen qe i takon autofaturimeve per sherbimet nga shoqerite jorezidente. Nje kuadrim i te ardhurave sipas kontabilitetit me te ardhurat sipas FDPve paraqitet si me poshte:

	2010 LEK	2009 LEK
Te ardhura nga shitja	79.776.617	56.530.563
Shtohen autofaturimet	16.125.603	34.697.411
Totali i te ardhurave sipas FDP-ve	<u><u>95.902.220</u></u>	<u><u>91.227.974</u></u>

Te ardhurat e perllogaritura perfaqsojne pjesen e sherbimeve te kryera gjate vitit 2010, te cilat u jane faturuar klienteve gjate 2011 ne perputhje me kontraten e sherbimit.

**14. KOSTO E PUNES**

Kosto e punes eshte analizuar si me poshte:

	2010 LEK	2009 LEK
Paga dhe shperblime	37.195.432	14.871.724
Sigurime shoqerore dhe shendetsore	2.157.463	1.873.501
	<u><u>39.352.895</u></u>	<u><u>16.745.225</u></u>



**15. SHPENZIME TE TJERA**

	2010 LEK	2009 LEK
Shpenzime energjie, uje, te tjera	357.875	407.805
Shpenzime qiraje	7.360.425	4.595.981
Shpenzime mirembajtje	446.061	497.351
Shpenzime edukimi i jashtem	307.804	651.529
Shpenzime konsulence financiare dhe ligjore	18.294.409	37.685.408
Shpenzime per udhetime e dieta	5.127.145	8.377.808
Shpenzime postare e telekomunikacioni	3.214.490	1.932.192
Kuote anetaresimi te IEKA	442.600	484.545
Shpenzime per pritje e percjellje	345.014	540.666
Kancelari	652.937	528.830
Shpenzime siguracioni	507.607	623.262
Shpenzime sponsorizimi	786.978	-
Shpenzime abonimi	1.085.869	-
Shpenzime pastrimi dhe sigurie	512.500	-
Te tjera shpenzime	3.150.250	1.275.914
	<u>42.591.964</u>	<u>57.601.291</u>

**16. FITIME / (HUMBJE) NGA KURSET E KEMBIMIT**

Fitime / (humbje) nga kurset e kembimit jane analizuar si me poshte:

	2010 LEK	2009 LEK
Fitime nga kurset e kembimit	767.490	3.569.954
Humbje nga kurset e kembimit	(966.750)	(1.267.524)
	<u>(199.260)</u>	<u>2.302.430</u>

### 17. SHPENZIMI I TATIMIT MBI FITIMIN

Bazuar në legjislacionin Shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 10% për vitin 2010 (2009: 10%).

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore Shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore. Në vitin 2010 Shoqëria ka rezultuar me një fitim kontabël dhe fiskal (2009: humbje kontabel dhe fiskale) si me poshte:

	2010 LEK	2009 LEK
1 Fitim / (humbja) para tatimit	2.050.124	(8.561.158)
2 Zëra shpenzimesh të panjobura:	7.243.311	7.631.536
3 Fitimi / (humbja) fiscale (1+2)	9.293.434	(929.622)
4 (Humbje) te mbartura	-	-
5 Norma e Tatimit mbi fitimin	10%	10%
6 Shpenzim tatim fitimi	929.344	-